

VENDIM
Nr. 152, datë 19.2.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË BJELLORUSISË, PËR HEQJEN RECIPROKE TË KËRKESAVE
PËR VIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BJELLORUSISË PËR HEQJEN RECIPROKE TË
KËRKESAVE PËR VIZË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bjellorusisë, në vijim të quajtura “Palët”,

me dëshirën për të rritur dhe forcuar marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin midis Republikës së Bjellorusisë dhe Republikës së Shqipërisë,

me qëllim lehtësimin e udhëtimeve reciproke të shtetasve të të dyja shteteve si një mjet i rëndësishëm për thellimin e lidhjeve dhe mbështetjen e zhvillimit në të gjitha fushat me interes dypalësh,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e shtetit të njëres Palë, mbajtësit e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë, qëndrojnë, dalin dhe do të kalojnë transit nëpër territorin e shtetit të Palës tjetër pa viza, me kusht që kohëzgjatja e tyre qëndrimi nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes së tyre. Periudha e përgjithshme e qëndrimit të tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër nuk duhet të jetë më e gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një viti kalendarik.

Neni 2

Shtetasit e shtetit të njëres Palë, që synojnë të qëndrojnë në territorin e Shtetit të Palës tjetër për një periudhë më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë, pavarësisht nga qëllimi i udhëtimit, duhet të marrin vizë në misionin diplomatik ose konsullor të shtetit të Palës tjetër në përputhje me

legjislacionin e saj kombëtar para se të hyjë në territorin e tij.

Neni 3

Shtetasit e Shtetit të njëjës Palë që kanë dokumente të vlefshme udhëtimi hyjnë, dalin dhe kalojnë transit nëpër territorin e Shtetit të Palës tjetër nëpërmjet pikave kufitare të përcaktuara sipas legjislacionit kombëtar të Shtetit të Palës tjetër për trafikun ndërkombëtar të udhëtarëve.

Neni 4

Shtetasit e shtetit të njëjës Palë gjatë qëndrimit në territorin e shtetit të Palës tjetër do të veprojnë në përputhje me legjislacionin e shtetit të Palës tjetër.

Neni 5

Secila Palë rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen ose të shkurtojë qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të Shtetit të Palës tjetër për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik.

Neni 6

Shtetasit e shtetit të njëjës Palë, të cilët nuk janë në gjendje të dalin nga territori i Shtetit të Palës tjetër brenda periudhës së përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme (si sëmundje, fatkeqësi natyrore ose të tjera) dhe që kanë dëshmi të dokumentuara ose të tjera të rrethanave të tilla mund të aplikojnë tek autoritetet përkatëse për zgjatjen e qëndrimit të tyre në territorin e shtetit të Palës tjetër.

Neni 7

1. Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike ekzemplarë të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë do të njoftojë Palën tjetër përmes kanaleve diplomatike për çdo ndryshim në dokumentet e listuara në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje dhe do të paraqesë mostrat e këtyre dokumenteve 30 (tridhjetë) ditë para fillimit të qarkullimit të tyre.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që lind midis Palëve nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nga palët nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 9

1. Secila Palë mund të pezullojë në tërësi ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit publik ose në rast të epidemive, fatkeqësive natyrore, aksidenteve teknologjike dhe situatave të tjera emergjente.

2. Pala do të njoftojë me anë të kanaleve diplomatike Palën tjetër për këtë vendim në kohën e duhur.

3. Pala do të informojë në mënyrë të njëjtë Palën tjetër lidhur me rinovimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

1. Marrëveshja lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me anë të të cilave Palët konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. 3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke njoftuar Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj pasi pala tjetër merr një njoftim të tillë.

Hartuar në, më, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe, bjelloruse dhe angleze, të gjitha tekste janë autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të përdoret teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
BJELLORUSISË

SHTOJCË

e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë

Lista e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, të kërkuara për udhëtimet reciproke pa vizë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve të Republikës së Bjellorusisë

1. Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë dokumentet e vlefshme gjatë udhëtimit të tyre në Republikën e Bjellorusisë, janë:

- 1.1 Pasaporta e zakonshme e një qytetari të Republikës së Shqipërisë;
- 1.2 Pasaporta diplomatike e një qytetari të Republikës së Shqipërisë;
- 1.3 Pasaporta e shërbimit të qytetarit të Republikës së Shqipërisë;
- 1.4 Dokument të vlefshëm udhëtimi për kthim në Republikën e Shqipërisë (vetëm për kthim në Republikën e Shqipërisë);
- 1.5 Dokumenti i identifikimit të detarëve (me regjistrimin në listën e anijeve ose ekstraktin prej tij).

2. Për shtetasit e Republikës së Bjellorusisë dokumente të vlefshme gjatë udhëtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë janë:

- 2.1 Pasaporta e një qytetari të Republikës së Bjellorusisë;
- 2.2 Pasaporta Diplommatike e një qytetari të Republikës së Bjellorusisë;
- 2.3 Pasaporta e Shërbimit të Qytetarit të Republikës së Bjellorusisë;
- 2.4 Certifikata e rihyrjes në Republikën e Bjellorusisë (vetëm për kthim në Republikën e Bjellorusisë);
- 2.5 Karta kombëtare e identitetit të detarit të Republikës së Bjellorusisë (bazuar në regjistrimin në listën e anijeve ose ekstraktin prej tij).